

VENDIM
Nr.911, datë 30.12.2011

**PËR NJË SHITESË FONDI NË LLOGARINË SPECIALE TË SHPRONËSIMEVE DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.909, DATË 28.12.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA, PËR INSTITUTIN E
SIGURIMEVE SHOQËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, në llogarinë speciale të shpronësimeve, t’i shtohet fondi prej 1 400 000 000 (një miliard e katërqind milionë) lekësh.

2. Fondi prej 1 400 000 000 (një miliard e katërqind milionë) lekësh të përballohet nga fondi i kontigjencës, për ruajtjen e deficitit për vitin 2011.

3. Pika 1 e vendimit nr.909, datë 28.12.2011 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e vitit 2011, në programin “Sigurimi shoqëror”, t’i shtohet fondi 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë.”.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha